

V E N D I M
Nr. 677, datë 20.12.2002

**PËR NËNSHKRIMIN E AKSIONEVE SHITESË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
KAPITALIN E AGJENCISË SË GARANTIMIT TË INVESTIMEVE SHUMËPALËSHE
(MIGA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 2 të ligjit nr. 7515, datë 1.10.1991 "Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Korporatën Financiare Ndërkombëtare, Shoqatën e Zhvillimit Ndërkombëtar, Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe dhe në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konfliktëve në Investime", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Nënshkrimin e 44 aksioneve shtesë, me vlerë 476. 080 (katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë) USD, të Republikës së Shqipërisë në kapitalin e Agjencisë së Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA). Nga kjo shtesë 84. 028 (tetëdhjetë e katër mijë e njëzet e tetë) USD ose 17.65 për qind të jenë të pagueshme në cash, ndërsa pjesa tjetër prej 392. 052 (treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëdhjetë e dy) USD ose 82.35 për qind e shtesës të përbëjnë kapitalin e thirrur.

2. Ngarkohet Ministria e Financave të përballojë fondet e nevojshme për pagesën e aksioneve shtesë, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, në cilësinë e Guvernatorit të MIGA-s për Republikën e Shqipërisë, të kryejë, në emër dhe për llogari të Republikës së Shqipërisë, të gjitha procedurat e nevojshme për pagesën e aksioneve shtesë në kapitalin e MIGA-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano